



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

---

**RREGULLORE (QRK) - NR. 04/2015 PËR KODIN E MIRËSJELLJES NË SHËRBIMIN CIVIL TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS<sup>1</sup>**

**REGULATION (GRK) - NO. 04/2015 ON CIVIL SERVANT CODE OF CONDUCT OF THE REPUBLIC  
OF KOSOVO<sup>2</sup>**

**UREDBA (VRK) - BR. 04/2015 O KODEKSU PONAŠANJA U JAVNOJ SLUŽBI REPUBLIKE  
KOSOVA<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, miratuar në mbledhjen e 17 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.05/17 me datë 07.03.2015.

<sup>2</sup> Regulation (GRK) - No.04/2015 on civil servant Code of conduct of the Republic of Kosovo, of approved on 17 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.05/17, date 07.03.2015.

<sup>3</sup> Uredba (VRK) - Br.04/2015 o Kodeksu ponašanja u javnoj službi Republike Kosova, usvojenje na 17 sednice Vlade Republike Kosova, odluku Br. 05/17 od 07.03.2015.

<p><b>Qeveria e Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Në pajtim me Nenin 6 dhe Nenin 95 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (GZ, nr. 72, 25 qershor 2010), si dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, nr. 15, 12 shtator 2011),</p> <p>Miratton:</p> <p><b>RREGULLORE (QRK) - NR.04/2015 PËR KODIN E MIRËSJELLJES NË SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktoj rregullat e mirësjelljes së nëpunësve në shërbimin civil të Republikës së Kosovës për arritjen e standardeve dhe të vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i shërbimit civil në Republikën e Kosovës.</p>	<p><b>Government of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, and in accordance with article, 6 and 95 of Law no. 03/L-149 on Civil Servant of the Republic of Kosovo (OG, no. 72, 25 June 2010) and article 19 (6.2) of Regulation no. 09/2011 of the Rules of Procedure of the Government (OG, no. 15, 12 September 2011),</p> <p>Approves:</p> <p><b>REGULATION (GRK) - NO.04/2015 ON CIVIL SERVANT CODE OF CONDUCT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</b></p> <p><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>1. This Regulation aims to determine the code of conduct for civil servants in the civil service of the Republic of Kosovo to meet the standards and to raise public awareness about the conduct that Civil Servant should have in Republic of Kosovo.</p>	<p><b>Vlada Republike Kosova,</b></p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova, i u skladu sa članovima, 6 i 95 Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republiek Kosova (SL br. 72, 25 jun 2010) i sa članom 19 (6.2) Pravilnika br. 09/2011 o radu Vlade (SL br. 15, 12 septemar 2011),</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>UREDBA (VRK) - BR.04/2015 O KODEKSU PONAŠANJA U JAVNOJ SLUŽBI REPUBLIKE KOSOVA</b></p> <p><b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>1. Ova uredba ima za cilj da definiše pravila ponašanja službenika javne službe Republike Kosova za postizanje standarda i da upozna javnost sa ponašanjem koje trebaju imati zaposleni u civilnoj službi na Republike Kosovu.</p>
---	--	---

<p>2. Kjo Rregullore ka për qëllim ruajtjen, afirmimin dhe ngritjen e dinjitetit dhe imazhit të nëpunësve civil, e cila ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve në punën e institucioneve.</p>	<p>2. This Regulation aims to preserve, affirm and raise the dignity and image of the civil employees, which leads to increased confidence in the work of institutions.</p>	<p>2. Ova Uredba ima za cilj očuvanj, afirmaciju i podizanje dostojnastva i poboljšanje imidža javne službenika koji utiču na povećanje poverenja građana u radu institucija.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p>
<p>1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për të gjithë nëpunësit civil, nëse nuk parashihet ndryshe në dispozitat tjera ligjore.</p>	<p>1. The provisions of this Regulation shall be obligatory to all civil servants, unless otherwise provided by other legal provisions.</p>	<p>1. Odredbe ova Oredba su obavezujuć za sve javne službenike, izuzev ako nije drugačije obezbeđen u drugim zakonskim odredbama.</p>
<p>2. Dispozitave të kësaj Rregulloreje i nënshtrohen edhe kategoritë:</p>	<p>2. The provisions of this Regulation shall be subject to the following categories:</p>	<p>2. Odredbama ova Oredba podležu i sledeće kategorije:</p>
<p>2.1. Nëpunësit e punësuar në kabinetet e funksionarëve publik;</p>	<p>2.1. Civil servants employed in the Cabinet of public functionaries;</p>	<p>2.1. Službenici zaposleni u kabinetima javnih funkcionera;</p>
<p>2.2. Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes;</p>	<p>2.2. Personnel employed by institutions of administration at central and municipal level, responsible for providing support and maintenance;</p>	<p>2.2. Osoblje koji radi u institucijama uprave na centralnom i opštinskom nivou, odgovorno za podršku i održavanje;</p>
<p>2.3. Personat e punësuar nga organizatat private që kryejnë shërbime në institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal;</p>	<p>2.3. Persons employed by private organizations who provide services in administration institutions at central and municipal level;</p>	<p>2.3. Lica zaposlena od privatnih organizacija koje pružaju usluge u institucijama uprave na centralnom i lokalnom nivou;</p>
<p>2.4. Punonjësit, ekspertët të cilët janë të kontraktuar nga institucionet, për</p>	<p>2.4. Employees, experts who are contracted by institutions to perform a</p>	<p>2.4. Zaposleni, stručnjaci koji su angažovani od strane institucija za</p>

<p>kryerjen e një shërbimi të caktuar (marrëveshjet për shërbimet e veçanta); si dhe</p> <p>2.5. Praktikantët.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termi nëpunës civil përfshin të gjitha kategoritë e të punësuarve sipas nenit dy (2) të kësaj Rregulloreje dhe kategoritë tjera në paragrafin dy (2) të këtij neni.</p> <p>2. Të gjitha termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Parimet themelore të Shërbimit Civil</b></p> <p>1. Nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrave të tyre janë të obliguar t’iu përmbahen parimeve themelore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil:</p> <p>1.1. <b>Ligjshmëria</b>– Nëpunësit civil ushtrojnë të gjitha detyrat në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare si dhe</p>	<p>certain service (agreements for special services);</p> <p>2.5. Interns.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. For purposes of the Regulation, the term civil servant includes all categories of employees according to article two (2) of this Regulation and other categories in paragraph two (2) of this Article.</p> <p>2. All terms used in this Regulation have the same meanings with definitions in Law No.03/L-149 on Civil Service of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 Fundamental principles of the Civil Service</b></p> <p>1. The civil servants during performance of their duties are obliged to adhere to basic principles of the Law No.03/L-149 on Civil Service:</p> <p>1.1. <b>Legality</b> – Civil servants shall exercise their duties based on Constitution, and international legislation in force;</p>	<p>obavljanje određenih usluga (specijalni aranžmani za usluge); kao i</p> <p>2.5. Pripravnici.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. U svrhe ova Oredba, termim javni službenik obuhvata sve kategorije zaposlenih prema članu dva (2) ova Oredba i ostale kategorije u stavu dva (2) ovog člana.</p> <p>2. Ostali upotrebljeni termini u ovpj Uredbi imaju isto značanje kao i definicije date u Zakonu Br.03/L-149 o Civlinoj službi Republike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4 Opšta Načela Javne Službe</b></p> <p>1. Javni službenici, tokom obavljanja njihovih zadataka treba da se pridržavaju opštim načelima iz Zakona Br.03/L-149 o civilnoj službi:</p> <p>1.1. <b>Zakunitost</b> – Javni službenici, sve njihove zadatke obavljajuna osnovu Ustava, primenjivih medjunarodnih instrumenata i važećeg zakonodavstva;</p>
---	---	--

<p>legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.2. <b>Jodiskriminimi</b> - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal;</p> <p>1.3. <b>Detyrimi për t’iu përgjigjur kërkesave</b> - Nëpunësit civil duhet t’u përgjigjen dhe të reagojnë shpejt ndaj kërkesave, iniciativave ose ankesave të dorëzuara nga individët, organizatat private ose organe të tjera të administratës publike;</p> <p>1.4. <b>Efektshmëria dhe efikasiteti</b> - Nëpunësit civil duhet të sigurojnë zbatimin e thjeshtë dhe ekonomik të rregullave dhe procedurave administrative për përmbushjen e objektivave të administratës në interesin publik, në të mirë të administratës publike dhe të qytetarëve;</p> <p>1.5. <b>Përgjegjësia</b> - Nëpunësit civil janë të detyruar që të raportojnë,</p>	<p>1.2. <b>Non-discrimination</b> - No direct or indirect discrimination is allowed on the basis of race, colour, sex, language, religion, political or other opinion, national or social origin, association with a community, property, economic, social, sexual orientation, birth, disability or other personal status;</p> <p>1.3. <b>Obligation to respond to requests</b> - Civil servants should respond and react quickly to requests, initiatives or complaints submitted by individuals, private organizations or other public administration bodies;</p> <p>1.4. <b>Effectiveness and efficiency</b> - Civil servants should provide simple and economical implementation of rules and administrative procedures to achieve the objectives of administration and public interest and good public administration and citizens;</p> <p>1.5. <b>Responsibility</b> - Civil servants are obliged to report, explain and respond</p>	<p>1.2. <b>Nediskriminacija</b> - Nije dozvoljena nikakva direktna niti indirektna diskriminacija po osnovu rase, boje, pola, jezika, veroispovesti, političkog ili drugog mišljenja, nacionalnog ili socijalnog porekla, povezanosti sa nekom zajednicom, imovine, ekonomskog, društvenog stanja, seksualnog opredeljenja, rođenja, ograničene spobnosti ili drugog ličnog statusa;</p> <p>1.3. <b>Obaveza da se odgovori na zahteve</b> – Javni službenici treba da odgovore i brzo reaguju na zahteve, inicijative ili žalbe koje podnose pojedinci, privatne organizacije ili drugi organi javne uprave;</p> <p>1.4. <b>Efektivnost i efikasnost</b> - Javni službenici moraju obezbediti jednostavnu i ekonomičnu primenu administrativnih pravila i procedura za ostvarivanje ciljeva u administraciji i u javnom interesu i o korist javne uprave i građana;</p> <p>1.5. <b>Odgovornost</b> - Javni službenici su dužni da prijave, objasne i da bude</p>
--	---	--

<p>shpjegojnë dhe të përgjigjen për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre administrative;</p> <p><b>1.6. Paanësia dhe pavarësia profesionale</b> - Nëpunësit civil nuk u lejohej njëanshmëria, që do të thotë të ketë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situatë, duke shkaktuar si rrjedhojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtën e palëve të tjera të interesuara;</p> <p><b>1.7. Transparenca</b> - Nëpunësit civil ruajnë konfidencialitetin e informacionit, që kanë në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që dalin nga legjisllacioni që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike. Proceset në shërbimin civil janë të hapura për publikun;</p> <p><b>1.8. Shmangia e konfliktit të interesit</b> - Nëpunësit civil duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civil veprojnë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe Ligjit përkatës për shmangien e konfliktit të</p>	<p>to consequences of decisions, actions and inactions of their administration;</p> <p><b>1.6. Impartiality and professional independence</b> - Civil servants should not remain impartial, which means to have a predisposition in favour of a particular outcome during assessment, therefore by causing an unjustifiable harm to public interest or to the right of other interested parties;</p> <p><b>1.7. Transparency</b> - Civil servants shall keep confidentiality of information at their disposal, but without prejudice to obligations arising from legislation related to access to public documents. Processes in the civil service are open for public;</p> <p><b>1.8. Avoiding conflict of interest-</b> The civil servant shall not allow his private interests to interfere with his public position, to avoid performing of any private or public duty, that will be in contradiction with their position and that could create a conflict of interest. civil servants shall act in accordance with the provisions of this Regulation and the respective relevant Law to avoid conflicts of interest;</p>	<p>odgovorni za posledice odluka, njihovih administrativnih postupka i nepostupaka;</p> <p><b>1.6. Nepristrasnost i profesionalna nezavisnost</b> - Javni službenici ne smeju biti pristrasni, što znači da ne smeju imati predispoziciju u korist određenog rezultata tokom procene situacije, koja ima za posledicu neopravdanu štetu po javni interes ili pravima stranaka drugih zainteresovanih strana;</p> <p><b>1.7. Transparentnost</b> - Javni službenici čuvaju poverljivost informacija na raspolaganju, ali bez ugrožavanja izvršavanja obaveza koje proističu iz zakonodavstva u vezi sa pristupom javnim dokumentima. Procesi u javnoj službi su otvoreni za javnost;</p> <p><b>1.8. Izbegavanje konflikta interesa</b> - Javni službenici ne bi trebalo da dozvole da se njihovi privatni interesi sukobljavaju sa njihovim javnim položajem, da izbegavaju obavljanje privatnih ili javnih, dužnosti, koje su u suprotnosti sa njihovom pozicijom i koje bi mogle da stvore sukob interesa. Javni službenici postupaju u skladu sa odredbama ovog zakona i relevantan Zakonima vazencim za izbegavanje</p>
--	---	--

<p>interesit;</p> <p>1.9. <b>Parimi i mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini</b> – Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive.</p> <p><b>KAPITULLI II RREGULLAT E MIRËSJELLJES SË NËPUNËSVE CIVIL</b></p> <p><b>Neni 5 Mirësjellja e Nëpunësve Civil</b></p> <p>1. Nëpunësit civil në punën e tyre udhëhiqen nga parimi i pavarësisë profesionale, integritetit personal, përgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.</p> <p>2. Nëpunësit civil duhet t'i kryejnë punët dhe detyrat në mënyrë të drejtë dhe efikase.</p> <p>3. Nëpunësit civil duhet t'i shfrytëzojnë mjetet financiare publike në mënyrë të drejtë dhe të mos i keqpërdorin ato.</p>	<p>1.9. <b>The principle of equal opportunities for communities and gender</b> – Communities and their members shall have equal opportunity to participate in the civil service in institutions of central and local administration. Members of both genders shall have equal opportunity to participate in the civil service and public administration bodies.</p> <p><b>CHAPTER II CIVIL SERVANTS RULES OF CONDUCT</b></p> <p><b>Article 5 Civil Servants Code of Conduct</b></p> <p>1. Civil servants in their work shall act leded by the principle of professional independence, personal integrity, accountability and honour.</p> <p>2. Civil Servants should perform tasks and duties fairly and efficiently.</p> <p>3. Civil servants should use public funds fairly and not abuse them.</p>	<p>sukoba interesa;</p> <p>1.9. <b>Princip jednakih mogućnosti za zajednice i rodove</b> - Zajednice i njihovi pripadnici imaju jednake mogućnosti da učestvuju u javnoj službi u institucijama centralne i lokalne administracije. Jednake mogućnosti za učešće u civilnoj službi, u organima javne uprave imaju pripadnici oba pola.</p> <p><b>POGLAVLJE II PRAVILA PONAŠNJA JAVNIH SLUŽBENIKA</b></p> <p><b>Član 5 Ponašanje civilnih službenika</b></p> <p>1. Javni službenici, u njihovm radu treba da se rukovode načela profesionalne nezavisnosti, ličnim integriteta poštenja.</p> <p>2. Civilnih službenici, njihov epsolove i zadatke traba da obavljaju na pravilan i efikasan način.</p> <p>3. Civilnih službenici treba da koriste javna finansijaks sredstva na pravilna način i da ih ne zloupotrebljavaju.</p>
---	---	---

<p>4. Nëpunësit civil nuk duhet, në asnjë mënyrë, të keqpërdorin pozitën e tyre zyrtare për interesin e tyre personal apo interesin e dikujt tjetër.</p> <p>5. Nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare duhet të krijojnë dhe të ruajnë besimin e organit ku punojnë dhe atyre të cilëve iu shërbejnë.</p> <p>6. Nëpunësit civil ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale, me përgjegjësi dhe të pavarur, pa u ndikuar nga të tjerët.</p> <p>7. Nëpunësit civil duhet t'i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë transparente dhe të atillë që mundëson marrjen e informatave të palëve të interesuara, mundësinë e dialogimit me qytetarët dhe organizatat e interesit si dhe mbikëqyrjen legjitime.</p>	<p>4. Civil servants should not, in any manner, misuse their official position for personal interest or others interest.</p> <p>5. Civil servants during performance of their official duties shall establish and maintain the trust of the body where they work and those they serve.</p> <p>6. Civil Servants shall exercise their duties in a professional, responsible and independent manner and with no influence from outside.</p> <p>7. Civil servants should perform their duties in a transparent manner and such that allows receiving information from interested parties, the possibility of dialogue with citizens and organizations of interest as well as legitimate oversight.</p>	<p>4. Civilnih službenici, en smeju ni na koji način zloupotrebiti njih službeni položaj u njihovm ličnom interesu ili u interesu nekog drugog.</p> <p>5. Civilnih službenici, tokom vršenja njihovog službenog zadatka treba da stvore i očuvaju poverenja organa u kojem rade i onih kojima služe.</p> <p>6. Javni službenici, njihove zadatke obavljaju profesionalno, odgovorno i nezavisno, bez uticaja sa spolja.</p> <p>7. Javni službenici, njohe zadatke treba da ispune na transparentan način i na način koji omogućuje dobijanje informacija od zainteresovanih strana, omogućuje vodjenje dijaloga sa gradjanima i interesnim organizacijama i lgitimno nadgledanje.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Masat mbrojtëse</b></p> <p>1. Nëse nëpunësi civil konsideron se nga ai kërkohet të veprojë në kundërshtim me ligjin, etikën në punë, që rezulton në shkeljen e rregullave të Kodit të Mirësjelljes, shkeljet e këtilla duhet të paraqiten tek organi kompetent në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Measures of protection</b></p> <p>1. When a civil servant considers he or she is being required to act in accordance with the law, ethics in work resulting in violation of this Code of Conduct rules, such violations must be submitted to the competent authority in accordance with applicable law.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Zaštitne Mere</b></p> <p>1. Ako javni službenik smatra da se od njega traži da postupa suprotno zakonu, etici na poslu, što dovodi do kršenja pravila Kodesksa ponašanja, takva kršenja moraju se prijaviti nadležnom organu u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>



<p>2. Nëpunësit civil duhet të përmbahen prej situatave që në çfarëdo mënyre pengojnë marrjen e vendimeve të drejta dhe efikase e që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e politikave të shërbimit civil.</p> <p>3. Nëpunësit civil duhet të ruajnë sekretin zyrtar. Nëpunësit civil edhe pasi që të pushojnë së ushtruari detyrën duhet të vazhdojnë t'i përmbahen ruajtjes së sekretit zyrtar në pajtim me Ligjin përkatës për klasifikimin e informatave dhe rregullat e sigurisë si dhe Ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>E drejta e asocimit dhe nëpunësi civil</b></p>	<p>2. Civil servants should refrain from situations that in any way, interfere on making the right and efficient decisions related to drafting and implementing the civil service policies.</p> <p>3. Civil servants shall keep the official secret. The civil servants, even after leaving the job, shall continue to keep confidence regarding the duty exercised, in accordance with the relevant Law on classification of information and safety rules and relevant Law on the protection of personal data.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>The right of Association of Civil Servant</b></p>	<p>2. Javni službenici treba da se uzdrže od situacija koje na bilo koji način ometaju donošenje pravih i efikasnih odluka koje se odnose ne projektovanje i sprovođenje politika civilne službe.</p> <p>3. Javni službenici treba da čuvaju službenu tajnu. Javni službenici, čak i nakon napuštanja posla, treba da nastave da se pridržavaju očuvanju tajnosti, u skladu sa Zakonom važećim o klasifikaciji informacija i sigurnosnih propisa i Zakona važećim o zaštiti ličnih podataka.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Pravo pristupanja i javni službenik</b></p>
<p>1. Nëpunësi civil mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike, i ndonjë organizate a shoqate tjetër politike ose i ndonjë bashkësie fetare.</p> <p>2. Nëpunësit civil i ndalohet zhvillimi i veprimtarive partiake dhe fetare, organizatave dhe shoqatave politike (partive politike) në institucionet e shërbimit civil.</p> <p>3. Nëpunësi civil duhet të përmbahet nga angazhimi i tij aktiv në aktivitetet politike gjatë orarit të punës në shërbimin civil dhe nuk duhet të marr pjesë në</p>	<p>1. The civil servant can be a member of any political party or other political organization or association or of any religious community.</p> <p>2. Civil servant is prohibited to exercise political and religious, organizations and political associations (political parties) activities in institutions of civil service.</p> <p>3. The civil servant should refrain from his active engagement in political activities during performing the work in the civil service and should not participate in</p>	<p>1. Civilni službenik može da bude član političke stranke ili neke druge političke organizacije ili udruženja ili verske zajednice.</p> <p>2. Civilnom službeniku se zabranjuje vršenje partijskih i verskih delatnosti, političkih organizacija i udruženja (političkih partija) u insitucijama civilne službe.</p> <p>3. Javni službenici treba da se uzdrže od aktivnog angažovanja u političkim aktivnostima u obavljanju svojih poslova u civilnoj službi, a ne bi trebalo da učestvuju</p>

<p>aktivitete politike, që mund të rrezikojë ose që duket se mund të rrezikojë paanësinë e tij në punën e tij si nëpunës civil.</p> <p>4. Nëpunësi civil nuk bën të jenë të diskriminuar, apo t'i mohohen të drejtat për shkak të përkatësisë partiake, bindjeve të tyre politike apo fetare.</p> <p>5. Nëpunësi civil mund të merret me veprimtari sindikale dhe të jetë anëtar i sindikatave të ndryshme, në pajtim me ligjin.</p>	<p>political activities that could risk or appear to compromise their impartiality in their work as civil servants.</p> <p>4. The civil servant cannot be discriminated or his/her rights cannot be denied because of his/her political persuasions, political or religious beliefs.</p> <p>5. The civil servant can be engaged in trade-union activities and can be a member of different trade-unions in accordance with the law.</p>	<p>u političkim aktivnostima koje bi mogle ugroziti ili izgledaju da mogu ugroziti njihovu nepristrasnost u njihovm radu, kao javni službenici.</p> <p>4. Javni službenik ne može biti diskriminisan, ili da mu se uskraćuju prava zbog partijske pripadnosti, njegovih političkih ili verskih uverenja.</p> <p>5. Javni službenik može se baviti sidikalnom kativnošću i da bude člana raznih sindikata, u skladu sa zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Sjellja e nëpunësit civil ndaj qytetarit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Conduct of a Civil Servant toward the citizen</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Ponašanje javnih službenika prema gradjanima</b></p>
<p>1. Gjatë ushtrimit të detyrës nëpunësit civil duhet të:</p> <p>1.1. sillen në mënyrë profesionale dhe të respektojnë parimin e barazisë, duke përjashtuar çdo sjellje diskriminuese ndaj qytetarëve;</p> <p>1.2. përmbahen nga kufizimi i të drejtave të qytetarëve, përveç kur një kufizim i tillë është i bazuar me ligj;</p> <p>1.3. sillen në mënyrë të përmbajtur ndaj qytetarëve, si dhe me një kujdes të veçantë ndaj të moshuarve dhe</p>	<p>1. During performing the task, civil servant shall:</p> <p>1.1. respect the principle of equality, excluding every discriminating conduct towards the citizens;</p> <p>1.2. be restrained from limiting the rights of citizens, except when such limiting is in accordance with the law;</p> <p>1.3. act in restrained manner toward the citizens, and with a special care toward older people and people with</p>	<p>1. U toku obavljanja svojih zadataka, javnislužbenici treba:</p> <p>1.1. da poštuju načelo ravnopravnosti, isključujući svako diskriminatorскоponašanje prema gradjanima;</p> <p>1.2. da se uzdrže od ograničenja pravogradjanima, izuzev ako to ograničenje imazakonskog osnova;</p> <p>1.3. da se ponašaju uzdržano prema gradjanima kao sa posebnom pažnjom prema starijimosobama i onima sa</p>

<p>personave me aftësi të kufizuar;</p> <p>1.4. paraqiten në mënyrë korrekte dhe me përgjegjshmëri gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët ose nëpërmjet formave tjera të komunikimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Sjellja e nëpunësit civil ndaj stafit politik</b></p>	<p>disabilities;</p> <p>1.4. shall present himself/herself in a correct and responsible manner during their direct communication with citizens or through other forms of communication.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Conduct of a Civil Servant toward the Political Staff</b></p>	<p>posebnim potrebama;</p> <p>1.4. da se pristojno i odgovorno ponašaju, tokom neposrednog komuniciranja sa građanima ili kroz druge oblike komuniciranja</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Ponašanje javnih službenika prema političkom osoblju</b></p>
<p>1. Nëpunësit civil janë të obliguar që të respektojnë dhe të sillen në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme ndaj stafit politik.</p> <p>2. Duhet të ofrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënyrë që të mbështesin dhe zbatojnë me nderë dhe paanshmëri politikat e përcaktuara nga institucionet e caktuara.</p> <p>3. Nëpunësit civil duhet t'i ofrojnë stafit përkatës politik raporte të detajuara dhe me korrektësi në pajtim me ligjin.</p>	<p>1. Civil servants are obliged to respect and act in a correct and responsible manner towards political staff.</p> <p>2. Should provide their knowledge and skills in order to implement with honour and impartially the determined policies set forth by certain institutions.</p> <p>3. Civil servants should implement with honour and impartially the determined policies set forth by certain institutions.</p>	<p>1. Javni službenici su dužni da poštuju i da se pristojno i odgovorno ponašaju prema političkom osoblju.</p> <p>2. Treba da pokazuju njihovo znanje i njihove sposobnosti kako bi podržali i sprovodili časno i nepristarsno politike utrdjenih od strane odredjenih institucija</p> <p>3. Javni službenici treba da podnesu odgovarajućem političkom osoblju detaljne izveštaje i na korektan način, u skladu sa zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Sjellja e nëpunësit civil ndaj udhëheqësve</b></p> <p>1. Nëpunësit civil duhet të zbatojnë politikat e veprimit të udhëheqësve drejtues dhe sjellja e tyre duhet të jetë në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Conduct of the Civil Servant toward the Managers</b></p> <p>1. Civil servants should implement governing policies of leaders and their behaviour should be in full compliance with</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Ponašanje javnih službenika prema rukovodiocima</b></p> <p>1. Javni službenici treba da sprovede politike delovanja vodećih rukovodilaca i njihovo ponašanje treba da bude u</p>

<p>përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Nëpunësit civil duhet t'i ushtrojnë detyrat e tyre bazuar në planin e punës dhe objektivat e përcaktuara nga udhëheqësit drejtues.</p> <p>3. Nëpunësit civil duhet t'i paraqesin problemet që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrës dhe të diskutojnë për gjetjen e zgjidhjeve më efikase me udhëheqësit drejtues.</p> <p>4. Në rast të emërimit të udhëheqësit drejtues të ri, nëpunësit civil duhet të informojnë atë me kohë dhe në mënyrë të saktë për të gjitha çështjet, në mënyrë që të sigurojnë vazhdimësinë e punës në fushën përkatëse në institucion.</p>	<p>applicable law.</p> <p>2. Civil servants shall exercise their tasks based on the work plan and objectives determined by the managing authority.</p> <p>3. Civil servants shall present problems that occur during exercising and discuss on finding the most effective solutions with the managers.</p> <p>4. In case of appointment of a new managing authority, the civil servants shall inform it on time and in a correct manner on every issue in order to assure the continuity of the work in the relevant field of institution.</p>	<p>potpunosti u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>2. Javni službenici treba da obavljaju svoje dužnosti na osnovu njihovih planova rada i radnih ciljeva utvrdjenih od strane vodećih rukovodilaca.</p> <p>3. Javni službenici treba da prijave probleme koji se javljaju tokom vršenja dužnosti i da diskutuju o efiksnim rešenjima sa vodećim rukovodiocima.</p> <p>4. U slučaju imenovanja novog vodećeg rukovodioca, javni službenici treba da ga obavesti na vreme i precizan način o svim pitanjima, kako bi se obezbedio kontinuitet rada u odgovarajućoj oblasti u neinstitutiji.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Sjellja e udhëheqësve ndaj stafit</b></p> <p>1. Udhëheqësi duhet të jetë shembull i mirësjelljes për stafin që e udhëheq, si dhe t'i përmbahet rregullave të mirësjelljes gjatë ushtrimit të detyrës.</p> <p>2. Udhëheqësi duhet të respektoj dinjitetin, personalitetin, idetë dhe iniciativat si dhe të nxitë bashkëpunimin</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Conduct of Leading Directors towards staff</b></p> <p>1. Leading Director should be an example of conduct for their staff, and strictly adhere to the Code of Conduct during exercise of duty.</p> <p>2. Manager must respect the dignity, personality, ideas and initiatives in order to promote governing cooperation of civil</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Ponašanje rukovodilacaprema osoblju</b></p> <p>1. Rukovodioci treba da budu primer dobrog ponašanja za osoblje sa kojim rukovode, i da se strogo pridržavaju kodeksa o ponašanju prilikom obavljanja svojih zadataka.</p> <p>2. Rukovodioci treba da poštuju dostojanstvo, ličnost, ideje i inicijative i da podstiču saradnju sa osobljem sa kojima</p>

